

REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

SËRISHI KONSTITUTIV I KOSOVËS - KOSOVIA USTAVA
KOSOVO CONSTITUTIONAL SERVICE

Njësia org./Org./ Jedinič./Org./ Unit:
01 Nr./Br./No.: 2054 Data/Datum/Date: 08/12/09
Shtojca/Dodaci/Annex: 09

PRISHTINE/A



REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 01-1648
Data / Datum / Date: 08 / 12 / 20 09
Shtojca / Dodaci / Annex: _____
PRISHTINE/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

UA nr. 2009

Ministria e Drejtësisë, në mbështetje të nenit 92, pika (4), nenit 93 pika (4), nenit 145 pika (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 25 pika (7) të Rregullores për Punën e Qeverisë, të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 "Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë" neni 1.3 nën (ç), 1.6 dhe 1.7, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/53 të datës 20 dhjetor 2005 si dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/26 të datës 27 prill 2006, si dhe zbatimin e nenit 196, neni 77 dhe 79, të Ligjit mbi Ekzekutimin Sanksioneve Penale, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/46 e datës 19 nëntor 2004; nxjerr;

UDHËZIM ADMINISTRATIV MBI KUSHTET E PUNËS DHE SHPËRBLIMI PËR PUNËN E TË BURGOSURVE NË INSTITUCIONET KORREKTUESE

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të përcaktojë rregullat për kushtet e punës dhe shpërblimin për punën e të burgosurve në Institucionet Korrektuese duke e parë punën si një element pozitiv në trajtimin e tyre.

Neni 2

Objekti

Puna ka për qëllim që personi i dënuar të fitojë, të ruajë dhe të zhvillojë aftësitë punuese, shprehinë e punës dhe fitimin e njohurive të reja për fillimin e jetës normale sa më parë që është e mundur pas mbajtjes së dënimit

Neni 3

Përkufizimet

Për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

"Institucioni Korrektues" nënkupton Burgun, Qendrën Korrektuese dhe Qendrat e Paraburgimit.

"LESP" nënkupton Ligjin Mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale

Neni 4

Parimet per punën e të burgosurve

Puna në burg duhet parë si një element pozitiv në trajtimin e të burgosurve duke i trajtuar sipas parimeve në vijim:

- 4.1. Institucioni Korrektues mund t'iu kërkoj të burgosurve të dënuar që të punojnë, në vartësi të aftësive të tyre fizike e mendore, e përcaktuar nga mjeku.
- 4.2. Angazhimi në punë duhet të jetë i tillë që të ruaj ose të rrisë sa më shumë që të jetë e mundur aftësitë e të burgosurit për të bërë një jetë normale pas lirimit.
- 4.3. Të burgosurit që janë të aftë të përfitojnë e veçanërisht për të burgosurit e rinj do të sigurohet kualifikimi profesional në profesione të dobishme.
- 4.4. Puna e personave të dënuar duhet të jetë e dobishme dhe nuk guxon të jetë degraduese.
- 4.5. Puna nuk mund të imponohet si formë e dënimit disiplinor.
- 4.6. Realizimi i përfitimit ekonomik nga puna e të burgosurve nuk guxon të shkoj në dëm të qëllimit të trajtimit dhe punës të të burgosurve të dënuar.
- 4.7. Personi i dënuar mund të zgjedh llojin e punës që i pëlqen nëse është e zbatueshme dhe e disponon Institucioni Korrektues.
- 4.8. Personi i dënuar ka të drejtë në shpërblimin mujor për punën e tij, Shpërblimi për secilën kategori të punëtorëve të burgosur caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer.
- 4.9. Personi i dënuar lirshëm mund të disponoj me 70% të shpërblimit për punën e kryer, kurse pjesa e mbetur do të deponohet nga administrata e Institucionit Korrektues në gjyrollogarin e kursimit të të burgosurit për të ju dorëzuar me rastin e lirimit të tij.

Neni 5

Institucioni Korrektues do t'iu siguroj të burgosurve punë:

1. Në lokalet ,punishtet dhe fermat e saj;
2. Në agrikulturën (bujqësi) e institucionit

Në bashkëpunim me kontraktuesit privat dhe publik, brenda dhe jashtë institucionit dhe nga këto raste sipas marrëveshjeve me kontraktuesit, pagat e plota normale do të paguhen nga kontraktuesit për të cilët kanë punuar të burgosurit.

Neni 6

Masat paraprake për sigurinë në punë dhe shëndetin e të burgosurve gjatë punës do të zbatohen dispozitat e përgjithshme për mbrojtje në punë dhe kompensim në rast invaliditeti të cilat zbatohen në Republikën e Kosovës.

Neni 7

7.1. Institucioni korrektues, do të kujdeset që organizimi dhe metodat e punës të jenë sa më të përafërta me ato të punës në komunitet në mënyrë që ti përgatisin të burgosurit për kushtet e jetës profesionale normale në Republikën e Kosovës.

7.2. Secili Institucion Korrektues me specifikat e veta ,me një akt të brendshëm do të përcaktojë organizimin e vendeve të punës për të burgosur ,metodat dhe kushtet e punës

ne pajtim me dispozitat e përgjithshme të punës në Republikën e Kosovës, LEST, dhe standardet minimale të punës në këtë udhëzim administrativ.

Neni 8

Kushtet e punës

8.1 Orët standarde të punës për të burgosurit që punojnë janë katërdhjetë (40) orë në javë, duke përfshirë pauzat.

8.2 Çdo i burgosur i punësuar ka të drejtë një (1) orë pushim gjatë tetë (8) orëve të punës në ditë dhe, pos kësaj, një periudhë javore të pushimit së paku dyzet e tetë (48) orë.

8.3. Kur në pajtim me dispozitat të përgjithshme koha e kaluar në punë pranohet me qëllim të fitimit të kualifikimit profesional, koha e kaluar në llojin e njejtë të punës gjatë kohëzgjatjes së denimit me burgim ose burgim afatgjatë pranohet po ashtu për atë kualifikim.

8.4 Kur e kërkon puna me ndërrime, modelet e ndërrimeve i përcakton institucioni korrektues në pajtim me udhëzimet administrative që nxjerr Ministria e administratës publike.

Neni 9

Puna me orar të shkurtuar

9.1 Të burgosurit mund të punojnë me orar të shkurtuar në bazë të pajtimit të organit të punësim-it-institucionit korrektues.

9.2. I burgosuri i cili vijon shkollimin e përgjithshëm ose atë profesional punon me orar të shkurtuar.

9.3. Ministria lëshon udhëzime administrative në pajtim me dispozitat e përgjithme me anë të të cilave përcakton procedurat në lidhje me kushtet dhe rrethanat e punës me orar të shkurtuar.

Neni 10

Puna jashtë orarit

Personi i dënuar mund të urdhërohet të punoj jashtë orarit të punës deri në dy orë në ditë për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe kryerjen e obligimeve të zakonshme në Institucionin Korrektues.

Neni 11

Pushimi vjetor

Të burgosurit-punonjësi kanë të drejtë në tetëmbëdhjetë (18) ditë pune të pushimit vjetor me pagesë gjatë vitit kalendarik, të fituara në shkallën prej një ditë e gjysmë (1.5) për çdo muaj kalendarik të punësim-it. Pushimi i tillë mund të merret me miratimin e udhëheqësit.

Neni 12

Festat zyrtare

Zakonisht nuk kërkohet nga të burgosurit-punonjësi që të punojnë gjatë festave zyrtare. Mirëpo kur nga të burgosurit-punonjësi kërkohet që të punojnë gjatë festave zyrtare, atij ose asaj i takon një ditë e lirë për çdo festë zyrtare që ka punuar.

Neni 13

13.1 Të burgosurit-punonjës kanë të drejtë më së tepërmi pesëmbëdhjetë (15) ditë pushim mjekësor me pagesë për çdo vit kalendarik plus çfarëdo pushimi mjekësor për shkak të aksidenteve ose sëmundjeve në punë. Nëse punësimi fillon pas fillimit të vitit, e drejta e pushimit vjetor duhet të jetë në përpjesëtim me kohëzgjatjen e punësimit për atë vit.

13.2 Pushimi mjekësorë për shkak të aksidenteve në punë ose sëmundjes në punë mund të jepet me pagesë të plotë për një periudhë prej tre muajsh dhe me gjysmëpagesë për një periudhë vijuese prej tre muajsh nëse rekomandohet pushimi i tillë nga një mjeku i Institucionit Korrektues.

Neni 14

Shpërblimi për punën e të burgosurve

14.1 Personi i dënuar ka të drejtë në shpërblimin mujor për punën e tij, shpërblimi për secilën kategori të punëtorëve të burgosur caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer.

14.2 Ministria e Drejtësisë me vendim do të caktoj shumën e shpërblimit për punën ditore ose mujore për secilën kategori të punëtorëve të burgosur në pajtim me dispozitat e përgjithshme për pagat e punës në Republikën e Kosovës.

14.3 Personi i dënuar lirshëm mund të disponoj me 70% të shpërblimit për punën e kryer, kurse pjesa e mbetur do të deponohet nga administrata e Institucionit korrektues në xhirrollogarinë e kursimit të të burgosurit për të ju dorëzuar me rastin e lirimit të tij.

Neni 15

Dispozitat përfundimtare

Për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ ngarkohen Institucionet Korrektuese dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministria e Drejtësisë.

Prishtinë _____ 2009



Ministria e Drejtësisë

Nekibe Kelmendi/Ministre